



Pranuar / Dorezuar Punë/Prodato Received/Delivered	01.12.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Org / Unit	Ri Prot Ri Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKDMSHCK	7581/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.956/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga; Arben Mehmeti kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.956/2022, të datës 27.10.2022 të ankuesit me adresë banimi nga

kundër organit të punësimit Komuna e Ferizajit, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, neni 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 01.12.2022, mori këtë.

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa A.nr.956/2022 e datës 27.10.2022 e parashtruar nga ankuesi

Arsyetim

Ankuesi me datë 27.10.2022, ka parashtruar ankesën me numër protokollit 6496/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për harmonizimin e koeficientit nga gjashtë (6), në koeficient shtatë (7).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 01.11.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Ferizajit. Ndërsa me

datë 08.11.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga organi i punësimit së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.956/2022 të datës 27.10.2022 me numër protokolli 6496/2022 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 01.07.2011; Kërkesë për ngritje të koeficientit e datës 13.09.2013; Formulari për kërkesë apo ankesë e datës 03.06.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 15.06.2022; Kërkesë për rritje të koeficientit e datës 02.06.2022; Kërkesë e datës 17.06.2022; Formulari për kërkesë apo ankesë i datës 17.06.2022; Akt emërimi i datës 31.03.2017; Kërkesë për rivlerësimin e titujve të punës për shërbyesit civil e datës 04.03.2014; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 01.11.2022 me numër protokolli 6625/2022; Përgjigje në ankesë e datës 08.11.2022 nga organi i punësimit me numër protokolli 6881/2022 bashkë me shkresat e lëndës dhe Diploma e datës 27.03.1084 me nr.4952 e lëshuar nga Fakulteti Juridik në Universitetin e Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, është e pa lejuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale rezulton se ankuesi sipas Akt emërimit të datës 01.07.2011 ka pozitën Zyrtar i ndërrimeve kadastrale me koeficient gjashtë (6) në Drejtorinë e Urbanizmit, Pronës, Kadastrit, Gjeodezisë dhe mbrojtjes së Mjedisit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi me datën 02.06.2022 përmes udhëheqësit të tij ka parashtruar kërkesë për Kryetarin e Komunës së Ferizajit për ngritje të koeficientit nga gjashtë(6) në shtatë (7). Kryetari i Komunës së Ferizajit me datë 15.06.2022 i është përgjigjur ankuesit duke e sugjeruar që mbikëqyrësi juaj i drejtpërdrejt duhet të paraqes kërkesë në Drejtorinë e Financave, të njëjtën kërkesë ankuesi e ka përsëritur me datën 17.06.2022 përmes udhëheqësit të tij për Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit por nuk ka marrë asnjë përgjigje. Kundër heshtjes ndaj kërkesës të datës 17.06.2022 ankuesi ka parashtruar ankesë me datën 27.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se ushtrimi i ankesës me datë 27.10.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: *"4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ"*, nga se kemi të bëjmë me një kërkesë që është e datës 17/06/2022 dhe që është objekt i kësaj ankesë ndërsa ankesa në këshill është bërë më datë 27/10/2022 dhe në këtë kuptim është e palejuar bazuar në dispozitat e specifikuara si më lartë.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.




Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.860/2022, datë 01/12/2022

Sabile Avdyli



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Ferizajit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Ferizajit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

